



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.74

Prishtinë, më 22.12.2016, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi Shpejtim Bulliqi, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik dhe Shukrije Bytyçi.

Mungoi Sërgjan Popoviq

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive;

Nait Hasani, në hapje të takimit tha se kjo mbledhje e Komisionit është thirrur lidhur me vendimin për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit me plotësimin e rendit të ditës me

shqyrtimin e dytë të Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive.

Kryetari i Komisionit, në vijim të mbledhjes, i lexoi raportet me rekomandime të komisioneve të përhershme, lidhur me amendamentet e propozuara për Projektligjin për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive, raportet të cilat nuk kanë pasur vërejtje për amendamentet e propozuara.

Anëtarët e Komisionit votuan njëzëri për procedimin e Raportit me rekomandime për lexim të dytë të Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive.

3. Të ndryshme.

Në këtë pikë të rendit të ditës, Shpejtim Bulliqi propozoi që pas leximit të parë të Projektligjit për Buxhetin, Komisioni të mblidhet dhe të propozojë amendament përmes së cilit kërkohet gjetja e fondeve shtesë të nevojshme për ndërtimin e objektit të Fakultetit të Shkencave Matematikore-Natyrore.

Me këtë propozim u pajtuan anëtarët e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani